

VENDIM
Nr. 659, datë 26.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR GRADAT NË POLICINË E
SHTETIT DHE EKUVALENTIMIN E TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39 e 126 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Tabela e ekuivalentimit dhe e funksioneve korresponduese për çdo gradë”, bashkëlidhur dhe përmendur në pikën 1 të vendimit nr. 803, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e Policisë së Shtetit, për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha